

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush fshihet pas kokainës në Durrës?! Dyshime se u trafikua nga grupi i Gerd Gjinararit në Belgjikë
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/kush-fshihet-pas-kokaines-ne-durres-dyshime-se-u-trafikua-nga-grupi-i-i104242
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 14:22:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 14:08:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	df8dd4a448839cb9ff1b7288bb110c1c33fb906633312ed229efd214eefa5f38
TEKSTI	2671804bacada2d02a08ee5750a0cec31fac5cf8ab4efc98a0f72c41ec84b125
PAMJA	c6f5d2932d8b7acb045aa1a13775fedbbf29446d36dc99dd090d93ce88ee85ae

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3f76f907f63b8a103bf5d6783a2bea3134b8f7a507961d43359dc137f992ff3c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3f76f907f63b8a103bf5d6783a2bea3134b8f7a507961d43359dc137f992ff3c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)




Flash: **me lehtësira fiskale** Demokratike kërkon nga qeveria që të lehtësojë ■ **benet aktori me filmat më** karrierën e tij, duke u ngjitur në krye të listës ■ **ekstradimin e Ervin Matës** Shqipërisë për ekstradimin e Ervin ■ **me baktere për turistët AKU** qendrimin në ambientet ■ **shperblen trajnerin Luis de** nënshkrimin të kontrarës së re me

[AKTUALITET](#)

Kush fshihet pas kokainës në Durrës?! Dyshime se u trafikua nga grupi i Gerd Gjinararit në Belgjikë

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 16:08



Në Shqipëri, 37 pakot e kokainës së gjetura të hënën, në kontejnerin që transportonte mish pule nga Brazili, kanë mbetura jetime, pa asnjë të dhënë mbi destinacionin apo personat që fshihen pas ngarkesës. Por në të njëjtën ditë që ajo u zbulua në portin e Durrësit, në Belgjikë autoritet e atjeshme njoftojnë për goditjen e një grupi shqiptar të trafikut të kokainës, në Antwerp, falë një hetimi në bashkëpunim me disa vende, që kishte çuar dhe në kapjen e drogës në Shqipëri.

Lidhjen mes dy ngjarjeve e bën vetë zëdhënësi i Prokurorisë së Antwerpit, Kristof Aerts.

“Si pjesë e hetimit, u zhvillua një bashkëpunim i ngushtë me vendet e tjera dhe me Europolin. Kjo mund të rezultojë në arrestime jashtë vendit. Pas ndërhyrjes, një ngarkesë prej 37 kilogramësh kokainë u sekuestrua në Shqipëri, në një kontejner frigoriferik”, tha Kristof Aerts, zëdhënësi i Prokurorisë së Antwerp-it. Burime për Report Tv bëjnë me dije se çështja është referuar në SPAK, i cili pritet të marrë në vijim hetimin e plotë. Kokaina e nisur nga Brazili, kishte kaluar më parë tranzit përmes Greqisë.

Në Antwerp, grupi i narkotrafikantëve të goditur, rezultoi të jetë i lidhur me një personazh të njohur të botës së krimit në Shqipëri, Gerd Gjinarari, i arrestuar po në Belgjikë në muajin qershor. Tetë pjesëtare të grupit përfunduan në pranga, mes tyre një 46-vjeçar shqiptar, i dyshuar si ndërmjetës mes grupeve kriminale në Shqipëri dhe Amerikës Latine. Sipas hetuesve belgë, ai siguronte lidhjet për importimin e sasive të mëdha të kokainës, përmes portit të Antwerp-it, dhe kishte komunikime edhe me grupe të trafikut të drogës në Evropë e deri në Australi.

Emri i tij mbetet akoma mister, por ai rezultoi të ketë qenë në kontakt pikërisht me Gerd Gjinararin, një personazh me një të kaluar të hershme kriminale. Ai ishte 23 vjeç kur në vitin 1997 vrau Naim Zyberin në një spital në Milano, dhe bashkë me disa vepra penale u dënua me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Krimeve të Rënda e Milanos, vendim i formës së prerë që prej vitit 2001. Në 2014-ën u soll në Shqipëri për vijimin e dënimit, dhe në shkurt 2019 u lirua me kusht nga gjyqtari Markelian Kuqo në Korçë, vetëm pak kohë pasi u transferua në burgun e Drenovës.

Kur Apeli pak javë më vonë vendosi rikthimin e tij qeli, ishte arratisur.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 15 Shtator15:57

[Shtrenjtimi i naftës, PD: Qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale](#)

Pas shtrenjtimit të naftës në tregun me shumicë dhe pakicë, Partia Demokratike kërkon nga qeveria që të lehtësojë&...

AKTUALITET 15 Shtator15:51

[Wifi dhe alkool/ SPAK aksion blíc në sektorin ku mbahet Ergys Agasi](#)

Një kontroll i befasishtëm është zhvilluar në paraburgimin e Bradasheshit, në sektorin ku mbahet i izoluar biznesmeni Ergys Agasi, ...

AKTUALITET 15 Shtator15:45

[Gjykata e Brazilit miraton ekstradimin e Ervin Matës](#)

Gjykata Supreme Federale e Brazilit ka miratuar unanimisht kërkesën e Shqipërisë për ekstradimin e Ervin Matës. Vendimi është...

AKTUALITET 15 Shtator15:19

[Premium Beach Hotel në Golem servir djath me baktere për turistët, AKU zbarkon në hotel pas helmimit: Ja çfarë u konstatua...](#)

Një grup turistësh raportohet se janë helmuar gjatë qëndrimit në ambientet e 'Premium Beach Hotel' në Golem. Ngjarja ka ndodhur...

AKTUALITET 15 Shtator15:08

[Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare Prof. Dine Abazi, ish-presidenti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë](#)

Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare Prof. Dine Abazi, mjeku dhe ish-presidenti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë. ...

AKTUALITET 15 Shtator14:35

[Tentuan të vridnin një motor, policia zë “mat” dy hajdutët dhe i vë në pranga](#)

Dy shtetas grekë janë arrestuar nga policia në Athinë, pasi u kapën në flagrancë teksa dyshohet se po tentonin të vridh...

AKTUALITET 15 Shtator14:03

[“Marr armë nga Sudani”/ Çfarë fshihet pas përgjimit të Ron Yeffet?](#)

Audio-përgjimi i Ron Yeffet i publikuar nga ish-zv/kryeministri Arben Ahmetaj ka nxjerr në pah një skandal në Shqipëri se si janë...

AKTUALITET 15 Shtator13:41

[Rrëfihet 34-vjeçarja: Daja i Zegjine Caushit më çoi në ferra dhe më përdhuno! E kam takuar deputeten!](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak ditë më parë në Roskovec, ku Bledar Bakaj shkoi në shtëpinë e ish-bashkë...

AKTUALITET 15 Shtator13:27

[80 bimë kanabisi afër tokës së tij, arrestohet 41-vjeçari në Mallakastër](#)

Një 41-vjeçar është arrestuar në Mallakastër, pasi dyshohet se kishte kultivuar bimë narkotike n...

Piranjat News AKTUALITET 15 Shtator12:44

[VIDEO/ “Ku ka qiell e tokë, aty jam unë”/ Lulzim Caka udhëtoi lirisht në Zvicër dhe sfidonte policinë](#)

“Piranjat News” kanë zbuluar se Lulzim Caka fshihet me dy identitete, duke përdorur emrin e rremë “Pepe”. Ai përdo...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 14 Shtator

[FOTO- ‘Mos u kthe më në Shqipëri’/ Edi Rama sul...](#)

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 14 Shtator

[EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në kl...](#)

Një shtetas shqiptar është dënua me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eu...

BOTA 14 Shtator

[“E drog*va dhe abuz*va gruan për 20 vite”/ Bash...](#)

Një burrë britanik pranoi sot se kishte drogua dhe përdhunua gruan e tij në shtëpinë e tyre për rreth dy dekada. Burri, ban...


INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...


video





Çdo të premtë | ? 20:45 | ???? Syri TV





Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.